



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.11.2019, merr këtë

V E N D I M

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01-463/02-239184/19, TË
DT. 30.09.2019, PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE
ME PRONËN E PALUAJTSHME NË PRONËSI TË ALBAN (SULEJMAN)
RAMADANIT**

I.

MIRATOHET Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit 01-463/02-239184/19, të dt. 30.09.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Alban (Sulejman) Ramadanit.

II.

Sipas vendimit të cekur në pikën I, plotësim-ndryshimi nënkupton:

1. Ndryshohet pika II e Vendimit, shtohet "destinimi për parcelën publike, nr. P-71914059-07748-0, ZK Prishtinë, me destinim: zonë e planifikuar për ndërtim të lartë-miks në kuadër të Planit rregullues "Muhaxhirët", dhe parcelën private nr. P-71914059-01767-0, ZK Prishtinë, me destinim: hapësirë publike/rrugë, e planifikuar sipas Planit rregullues " Prishtina e Re - Zona Perëndim".

III.

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/02-275211/19, më 08.11.2019**

**KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta**

